VENDIM
Nr.654, datë 28.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 20, DATË 13.1.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në përbërjen e Komisionit të Ndihmës Shtetërore, të përcaktuar në pikën 1 të vendimit nr. 20, datë 13.1.2010 të Këshillit të Ministrave, në vend të z. Gjergj Thomai, anëtar, caktohet z. Besjan Pesha, anëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha